

Vulosje Dokumentash

-Çdo lloj certifikatë që lëshohet nga zyrat e Gjendjes Civile në Greqi (Liksiarcho & Dhimo), si dhe certifikata lindje, vdekje, familjare, martese etj , *vulosen vetëm* me VULE APOSTILE në Prefekturat (Periferia) e qyteteve/rretheve nga ku lëshohen dhe dërgohen në Shqipëri në Zyrat e Gjendjeve Civile.

Për informacion lidhur me Zyrat ku merret vula Apostile, klikoni në lidhjen si më poshtë:

<https://assets.hcch.net/docs/cc3ac3f9-737f-4749-95b6-408275d59a76.pdf>

-Çdo lloj veprimi i dalë nga Gjykatat greke si dhe prokurat e ndryshme që lëshohen nga noterë grekë (Simvoleografos), *vulosen vetëm* me VULE APOSTILE në Gjykatat e qyteteve/rretheve nga ku lëshohen dhe përdoren në Shqipëri.

Për më tepër informacion, lutemi klikoni në lidhjen si më poshtë:

<https://assets.hcch.net/docs/8056af52-3fab-4515-a3fb-2e948f3e0a33.pdf>

-Vendimet e zgjidhjes së martesave të Gjykatave greke, pasi marrin VULE APOSTILE dhe dërgohen në Shqipëri, duhet detyrimisht të njihen nga Gjykata e Apelit e Rrethit përkatës në Shqipëri.

-Zgjidhjet e martesave të bëra me marreveshje tek Noterë grekë (Simvoleografos), duhet të pajisen me VULE APOSTILE në Gjykatat e qyteteve/rretheve nga ku lëshohen, dhe më pas njihen direkt nga Zyrat e Gjendjes Civile përkatëse në Shqipëri.

Të gjitha dokumentet e lartpërmendura *përkthehen në Shqipëri*.

-Çdo lloj certifikate apo dukumenti tjetër që lëshohet nga Zyrat e Gjendjes Civile apo Institucionet në Shqipëri për përdorim në shtetin Grek, duhet të vulosen me VULE APOSTILE e cila merret vetëm në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme në Tiranë. Për më tepër informacion, klikoni në linkun si më poshtë:

<https://punetejashtme.gov.al/al/sherbime-dhe-mundesi/info-per-qytetaret-shqiptare/legalizimi-dhe-apostilimi-i-dokumenteve1612697847>

Të gjitha dokumentat e ardhura nga Shqipëria *përkthehen në Ministrinë e Jashtme Greke në Athinë*.